



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KËSHILLI**

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Koplik më: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2025

**V E N D I M**

*Nr 55 datë 11 / 12 / 2025*

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 11.12.2025, mbështetur në aktin normativ nr 3 datë 15.03.2020 neni 5, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.7/a, të Ligjit 94/2022 "PËR TITUJT E NDERIT DHE TITUJT VENDORË TË NDERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" neni 9 pika 1.

VKM Nr.861 datë 10.12.2014 Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

**VENDOSI**

T'i akordojë titullin "Qytetar Nderi "Z. **Muho Gjeto Danaj** me motivacionin:

"Për punën dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë, si një kontribues në fushën administrative dhe çdo detyrë të ngarkuar e kudo ku ka punuar dhe atë njerëzore humane duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe"

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Brendshme.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETAR**

Ilir Halaj

**SEKRETAR**

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 11.12.2025

Vota Pro 19

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 12.12.2025





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA MALESI E MADHE

Nr. 340. prot

Koplik më: 10/11/2025

**Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe  
Propozim për dhënie titulli “ Qytetarë Nderi “ i Bashkisë Malësi e  
Madhe z. Muho Gjeto Danaj**



Muho Gjeto Danaj ka lindur me 22 Shkurt 1945 në fshatin Lohe e Poshtme nga një familje patriotike me një qëndrim shëmbullorë si gjatë luftës antifashiste nacionalçlirimtare ashtu edhe mbas luftës. Për punën e kontributin e tij në dobi të komunitetit të lohes e më gjërë është zgjedhur Kryetar i Këshillit, detyrë të cilin e ka kryer me përkushtim deri në vitin 1978. Pas këtij viti duke njohur cilësitë e tij drejtuese e organizuese është emruar Përgjegjës Sektori e Zv.Kryetar i Ekonomisë Bujqësore dhe i Këshillit Bashkuar Velipojë detyra që i ka përbushur me mjaft profesionalizëm e ndershmeri. Për të tilla vlera e cilësi është vlerësuar dhe dekoruar me tituj e medalje të ndryshme nga Presidiumi i Kuvendit dhe Qeveria Shqiptare.

Pas viteve '90 dhe me daljen e tij në pension ai iu përkushtua fushës humanitare dhe pajtimtare duke shuar konflikte dhe pajtuar familje e individ me probleme të ndryshme sociale të kohës. Gjithashtu Muho Gjeto Danaj ka dhënë e po jep kontribut edhe në Organizatën e Veteranëve dhe Familjeve të Dëshmorëve, Dega Malësi e Madhe ku në qëndër të vëmëndjes janë respekti e mirënjohja për Dëshmorët e Atdheut. Muho Gjetja siç edhe e thët mbarë komuniteti malësorë gëzon respekt e mirënjohje nga mbarë banorët e territorit të Bashkisë Malësi e Madhe e mbarë Qarkut Shkodër.

Për gjitha sa thamë më lartë i propozohet Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe ti jepet titulli “ Qytetarë Nderi “ i Bashkisë Malësi e Madhe me

**motivacion:**

*“Për punën dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë, si një kontribues në fushën administrative dhe çdo detyrë të ngarkuar e kudo ku ka punuar dhe atë njerëzore humane duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe”.*

**KRYETAR BASHKIE  
TONIN MARINAJ**

